

**RREGULLORE
REVISTA CONTINUUM**



Neni 1

Baza ligjore

Rregullorja e funksionimit të revistës shkencore CONTINUUM mbështetet në Ligjin Nr. 7893, datë 22.12.1994 “Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik”, Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, i ndryshuar; Ligjin Nr.16/2018 “Për Diasporën” i ndryshuar, Ligjin Nr. 35/2026 “Për të Drejtat e Autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, si dhe aktet nënligjore në fuqi , VKM - në nr. 120, datë 27.01.1997 “Për shpërblimin e autorëve të veprave shkencore, teksteve shkollore dhe materialeve të tjera të dokumentacionit shkollor”, i indeksuar, VKM-në Nr. 601, datë 04.09.2019 “Për Krijimin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët”, Rregulloren e Botimeve të Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët si shtesë e Rregullores së Përgjithshme të QSPA-së.

Neni 2

Objekti i rregullores

Objekti i kësaj rregulloreje janë:

1. Parimet bazë të politikës editoriale që zbatohen nga redaksia e revistës shkencore që boton QSPA;
2. Mënyra e ngritjes dhe funksionimi i redaksisë;
3. Kriteret themelore të pranimit, vlerësimit, recensionimit, redaktimit dhe botimit të artikujve shkencorë;
4. Rubrikat e revistës.

Neni 3

Qëllimi i rregullores

Qëllimi i kësaj rregulloreje është:

1. Të përcaktojë standarde të njësuara shkencore dhe teknike sipas kërkesave të njohura ndërkombëtarisht, që garantojnë origjinalitet dhe cilësi;
2. Të vendosë dhe të shpallë rregullat e standardizimit teknik që zbatohen në marrëdhënien midis redaksisë dhe autorëve që kanë interes të botojnë artikuj shkencorë, recensione dhe informacione në to;
3. Të caktojë kompetencat dhe përgjegjësitë e redaksisë si ushtruese e funksionit të QSPA si ent botues, si dhe detyrimet ndaj organizmave dhe subjekteve shkencore ndërkombëtare që certifikojnë botimet periodike shkencore.

Neni 4

Etika në botimin e revistës

1. Pranimi i kontributeve shkencore për botim në revistë bëhet në përputhje me praktikën më të mirë të etikës së botimit, duke respektuar kërkesat në lidhje me autorësinë dhe ndalimet për dorëzimin e dyfishtë, plagjiaturën, manipulimin e figurave dhe konfliktin e interesit;
2. Etika e botimit të Revistës mbështetet në *Kodin Evropian të Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor*.

Neni 5

Parime të përgjithshme

1. Revista shkencore CONTINUUM (më tej “Revista”) është botim i Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (më tej “QSPA”);
2. QSPA ruan të drejtën ekskluzive të botimit të revistës;
3. Revista botohet një herë në vit;
4. Revista mbështetet mbi parimet e mëposhtme:
 - a. Realizon recensimin e artikujve sipas një procedure të formalizuar, e cila duhet të jetë publike *ex et ante* (paraprakisht dhe pas botimit), e garantuar nga një bord shkencor;
 - b. Siguron anonimitetin e recensionuesve që bëjnë vlerësimin paraprak të punimeve për pranimin e tyre për botim;
 - c. Respekton standardet ndërkombëtare të katalogimit dhe indeksimit shkencor;
 - d. Revista botohet në shqip;
 - e. Titulli i artikullit, abstrakti dhe fjalët kyçe paraqiten edhe në gjuhën italiane;
 - f. Revista mban në kopertinë emrin dhe stemën e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA).

Neni 6

Qëllimi i revistës

1. Revista CONTINUUM ka për qëllim të trajtojë çështje studimore të komunitetit arbëresh në Italinë e Jugut dhe arbëreshëve të Zarës. Ajo synon të mbledhë vlerësimet akademike të studiuesve të fushave të ndryshme dhe të informojë publikun në fushat filologjike, historike, etnografike, të antropologjisë kulturore, të shkencave shoqërore dhe të komunikimit, kulturës dhe artit;
2. Revista ka për qëllim të bëjë të njohura arritjet më cilësore shkencore që trajtojnë gjuhën, kulturën dhe historinë arbëreshe brenda dhe jashtë vendit; të mbajë dhe të rikonfirmojë në vijimësi lidhjet mes studiuesve shqiptarë,

- arbëreshë dhe studiuesve të tjerë të huaj;
3. Botimi i Revistës nuk ka qëllim fitimprurës.

Neni 7

Rubrikat e përhershme

1. Rubrikat e përhershme në revistën CONTINUUM respektojnë raportet dhe renditjen sipas standardeve të *Internacional Center of ISSN* dhe janë: 1. Artikujt shkencorë; 2. Recensionet; 3. Informacioni shkencor;
2. Raportet mes tri rubrikave të përhershme në tërësinë e lëndës së numrit janë si vijon: a) *Artikuj shkencorë* – jo më pak se dy të tretat e vëllimit; b) *Recensione, kritikë e bibliografi* rreth botimeve të QSPA apo botime të tjera shkencore që trajtojnë kulturën, historinë dhe aktualitetin arbëresh – deri në një të pestën e vëllimit; c) pjesë plotësuese e periodikut është *rubrika e kronikës dhe informacionit* për veprimtarinë e QSPA-së ku përfshihen, kuvende, konferenca, seminare, projekte, ekspedita studimore, kushtime *in memoriam* dhe *ad honorem*);
3. Në raste të veçanta mund të shtohet edhe rubrika *Materiale e dokumente*, që konsiderohet informacion shkencor. Si pjesë plotësuese e rubrikës së *artikujve shkencorë* mund të jetë edhe *Forumi*, i cili nëpërmjet një tematike të përcaktuar nga redaksia fton studiuesit e fushës të diskutojnë, argumentojnë dhe të shprehin opinionin e tyre mbi të.

Neni 8

Artikulli shkencor

1. Artikulli shkencor që dorëzohet për botim në revistën CONTINUUM duhet të jetë sipas sistemit të referimit të vendosur nga redaksia e revistës dhe që bëhet me dije nëpërmjet guidës së autorëve të publikuar në faqen zyrtare të QSPA.

Neni 9

Periodiciteti

1. Revista CONTINUUM del rregullisht një herë në vit. Për numrin jashtë këtij periodiciteti vendos redaksia;
2. Numri jashtë rregullsisë periodike quhet *numër special*;
3. Vonimi i numrit më shumë se një vit konsiderohet prishje e periodicitetit dhe cënim i statusit të periodicitetit.

Neni 10

Burimet e lëndës shkencore

1. Përgatitja e numrit vijues të periodikut nis një vit përpara, me thirrjen për kontribut, e cila konceptohet dhe shpallet nga vetë redaksia e revistës. Përmbajtja e numrit përbëhet nga punimet shkencore të studiuesve të QSPA dhe nga punime të autorëve të interesuar në përgjigje të thirrjes për kontribut;
2. Për revistën CONTINUUM kanë përparësi kontributet për çështje të ndjeshme në lidhje me gjuhën, kulturën, historinë dhe aktualitetin arbëresh. Redaksia nxit debatin shkencor dhe fton për kontribute ekskluzive autorë nga radhët e studiuesve të huaj;
3. Nuk mund të përzgjidhen artikuj shkencorë që janë botuar ose janë në proces botimi.

Neni 11 **Struktura e Revistës**

Struktura e Revistës përbëhet nga:

- a) Drejtori i Revistës
- b) Kryeredaktori
- c) Redaktori shkencor
- d) Komiteti shkencor
- e) Redaksia
- f) Bordi i nderit

Në strukturën e Revistës do të përfshihen Drejtori ekzekutiv i QSPA, anëtarë nga stafi i studiuesve të QSPA dhe të ftuar, studiues të spikatur të fushave të studimit shkencor dhe përfaqësues të institucioneve kërkimore shkencore.

Qendra e Studimeve dhe Përkimeve për Arbereshet

Neni 12 **Drejtori i Revistës**

Drejtori i revistës “Continuum” është Drejtori ekzekutiv i QSPA. Detyrat e drejtorit të revistës janë:

- a. Orienton politikën editoriale të Revistës, duke marrë në konsideratë sugjerimet e komitetit shkencor/bordit editorial;
- b. Zgjedh kryeredaktorin e revistës;
- c. Në bashkëpunim me kryeredaktorin e Revistës, vendos ura bashkëpunimi me komunitetet shkencore, brenda apo jashtë vendit, me të cilat përputhen interesat dhe fushat e studimit që mbulohen nga rubrikat e përmbajtjes së Revistës;
- d. Harton raportin vjetor në lidhje me vlerësimin e performancës së Revistës, perspektivat në vijim dhe drejtimit që duhen marrë në konsideratë;
- e. Së bashku me kryeredaktorin thërret komitetin shkencor të Revistës, në fillim të vitit kalendarik, për të përvijuar me vendimmarrjen mbi ciklin e

veprimtarive për numrin e ardhshëm të Revistës.
Drejtori ka të drejtën e informimit nga kryeredaktori për ecurinë e punës editoriale të revistës dhe merr pjesë në mbledhjet e redaksisë për të dhënë sugjerimet e ti/saj.

Neni 13

Kryeredaktori

1. Kryeredaktori i Revistës kryen këto detyra:
 - a. Drejton mbledhjet e redaksisë së revistës;
 - b. Në bashkëpunim me drejtorin e revistës dhe anëtarët e redaksisë dhe propozimet e komitetit shkencor, harton tematikën dhe përcakton burimet e lëndës shkencore;
 - c. Në bashkëpunim me drejtorin e revistës, redaktorin shkencor dhe anëtarët e redaksisë, harton kriteret shkencore të botimit, strukturën e artikujve shkencorë dhe/ose recensave, si dhe të rubrikave të përmbajtjes së revistës, në zbatim të vendimeve të komitetit shkencor të revistës;
 - d. Siguron zbatimin e kërkesave të Kodit të Etikës së Kërkimit Shkencor;
 - e. Përgjigjet për cilësinë e shkrimeve të revistës;
 - f. Komunikon me autorët, recensentët dhe redaktorët për mbarëvajtjen e proceseve realizuese të revistës;
 - g. Bashkërendon punën me drejtorin e revistës për politikën dhe procedurat e realizimit të aspekteve të ndryshme të saj;
 - h. Kryen shpërndarjen e punëve për redaksinë, sipas fushave dhe nënfushave të studimit;
 - i. Mbikqyr progresin e recensimit dhe ndihmon për zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë punës;
 - j. Miraton variantin përfundimtar të botueshëm të Revistës;
 - k. Garanton nivelet e respektimit të së drejtës së autorit për secilin artikull dhe për Revistën në tërësi;
 - l. Kryen verifikimin e informacioneve, nëse lind një nevojë e tillë;
 - m. Zhvillon takime me drejtorin e revistës dhe komitetin shkencor, kur gjykon që duhen parashtruar çështje për diskutim;
 - n. Vlerëson dorëshkrimet e dorëzuara për botim për përmbajtjen e tyre shkencore pa asnjë lloj diskriminimi.

Neni 14

Redaktori shkencor

1. Redaktori shkencor i revistës kontraktohet kur është e nevojshme si bashkëpunëtor i jashtëm *ad hoc* i revistës, dhe është përgjegjës për procesin e shqyrtimit të Revistës nga pikëpamja redaktoriale shkencore;
2. Redaktori shkencor mban lidhjet midis redaksisë, autorëve dhe recensuesve; pranon dhe koleksionon lëndën e numrit të ri në një dosje të veçantë; i paraqet

periodikisht kryeredaktorit gjendjen e lëndës që disponohet për numrin e ri; njofton anëtarët e redaksisë me një relacion paraprak për prurjet; bën sugjerimet për shtesat e nevojshme të lëndës së numrit; propozon përmbajtjen e tij, si dhe redakton lëndën e numrit në gjuhën e botimit.

3. Redaktori shkencor vlerëson variantin përfundimtar të botueshëm të Revistës sipas kritereve të shkrimit akademik dhe llojeve të tij. Ai, së bashku me anëtarët e redaksisë kryen verifikimin e informacioneve dhe jep sugjerime për redaktime, duke u këshilluar me recensentët e fushës përkatëse të studimit, bën shpërndarjen e punëve për redaktorët dhe recensentët sipas fushave dhe nënfushave të studimit; mbikqyr progresin e recensimit dhe ndihmon për zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë punës. Redaktori shkencor kryen redaktimin shkencor-referencial sipas sistemeve ndërkombëtare të referencave.

Neni 15 **Komiteti shkencor**

1. Komiteti shkencor përbëhet nga anëtarë të jashtëm, ekspertë në fushën e tyre që përkon me qëllimin dhe objektin e studimit të revistës (ekspertë me kontratë shërbimi) dhe anëtarë të brendshëm, nga stafi i studiuesve të QSPA-së (punonjës me kontratë të përhershme);
2. Komiteti shkencor përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, të cilët anëtarësohen në përputhje me parimet e Kodit Europian të kërkimit shkencor;
3. Komitetit shkencor i janë besuar politikat drejtuese të revistës “Continuum” dhe identifikon temat për çështje të veçanta;
4. Komiteti shkencor së bashku me kryeredaktorin dhe redaktorin shkencor janë përgjegjës për vlerësimin, pranimin ose refuzimin e artikujve të ardhura në revistë;
5. Anëtarët e komitetit shkencor mund të jenë pjesë e procesit të recensionimit (peer review) si specialist të fushës përkatëse të ekspertizës dhe mund të sygjerojnë recensues të tjerë në përshtatje me fushën përkatëse;
6. Anëtarët e komitetit shkencor kanë një pozicion kyç dhe duhet të shmangin konfliktin e interesit;
7. Anëtarët e komitetit shkencor e kanë për detyrë të mos përcjellin asnjë informacion në lidhje me artikujt e dorëzuara palëve të treta ose individëve ose organizatave të paautorizuara;
8. Në rast se artikulli i dorëzuar refuzohet, shtyhet ose nuk botohet, anëtarët e komitetit shkencor nuk do të publikojnë ose përdorin informacionet që gjenden në të pa pëlqimin paraprak të autorit.

Neni 16 **Redaksia/stafi**

1. Anëtarët e redaksisë së revistës, janë studiues të Qendrës së Studimeve dhe

- Publikimeve për Arbëreshët, punën e redaksisë e kanë pjesë të detyrës së tyre funksionale, pa marrëdhënie financiare shtesë;
2. Përgjegjësia për cilësinë botuese dhe shkencore të revistës është e redaksisë së bashku me Kryeredaktorin.

Neni 17

Bordi i nderit

1. Bordi i nderit ngrihet sipas standardeve të International Center of ISSN, të cilët anëtarësohen në përputhje me parimet e Kodit European të Kërkimit Shkencor;
2. Bordi i nderit është një ekip ekspertësh në fushën e tyre dhe ka funksion këshillimor për përmbajtjen dhe nxitjen për kontribute të autorëve.
3. Bordi Këshillimor mund të ndikojë në cilësinë e revistës, kështu që redaksia duhet të marrë parasysh sa vijon:
 - Vendndodhja e anëtarëve të Bordit duhet të pasqyrojë shtrirjen e revistës;
 - Njohuritë specifike të anëtarëve të bordit duhet të përfaqësojnë qëllimin e revistës;
 - Anëtarët e bordit zakonisht ftohen drejtpërdrejt nga redaksia bazuar në kriteret e mësipërme;Funksionet e Bordit përfshijnë:
 - Anëtarë të Bordit mund të jenë pjesë e procesit të recensionimit (peer review) si specialist të fushës përkatëse të ekspertizës;
 - Promovon revistën te kolegët;
 - Ndhmon redaksinë në marrjen e vendimeve për çështje të tilla si pretendimet dhe paraqitjet për plagjiaturë ku recensentët nuk mund të bien dakord për një vendim.

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët

Neni 18

Redaktori gjuhësor

1. Redaktori gjuhësor do të kontraktohet kur është e nevojshme si bashkëpunëtor i jashtëm *ad hoc* i Revistës, dhe është përgjegjës për procesin e shqyrtimit të Revistës nga pikëpamja redaktoriale gjuhësore.
2. Redaktori gjuhësor bashkërendon punën me kryeredaktorin dhe vlerëson në aspektin gjuhësor variantin final të botueshëm të Revistës.

Neni 19

Recensionimi

1. Recensuesit e artikujve që botohen te revista “Continuum” zgjidhen, në përputhje me parimin e kompetencës në fushën e ekspertizës;

2. Redaksia koncepton dhe miraton formularin standard të recensionimit, që përfshin interesin shkencor, origjinalitetin, përputhshmërinë me prioritetet e revistës, përjashtimin e konfliktit të interesit dhe mangësitë e mundshme;
3. Marrëdhëniet e redaksisë me autorët dhe recensuesit ndërtohen sipas parimeve dhe procedurave ndërkombëtare të standardit të vlerësimit të fshehtë *peer review* (nga dy specialistë të ndryshëm të fushës), që garanton origjinalitetin, vlefshmërinë dhe cilësinë e artikujve;
4. Recensenti kontraktohet kur është e nevojshme si bashkëpunëtor i jashtëm *ad hoc* i revistës. Recensenti garanton standardet e shkrimit akademik në hartimin e artikujve shkencorë sipas Kodit të Etikës së botimit, standardeve të komunikimit dhe sipas Manualit Frascati - Frascati manual dhe tipologjitë e botimeve shkencore;
5. Recensenti, përmes mendimit analitik të shprehur në recensat përkatëse të artikujve shkencorë, është përgjegjës për përmbajtjen shkencore të artikullit që analizon. Ai kryen verifikimin e informacioneve të shkrimit për botim dhe i jep sugjerime kryeredaktorit të Revistës për redaktimet e nevojshme;
6. Përgjigja e recensuesve mund të jetë në favor të punës së dorëzuar; mund të jetë negative dhe e shoqëruar me arsyet e refuzimit; mund të jetë gjithashtu në favor të publikimit pas përmirësimeve të mëtejshme të përmbajtjes e shoqëruar me sugjerime për autorin.

Neni 20

Standardet teknike

1. Formatimi teknik i tekstit që botohet në revistë (lloji i shkronjës, madhësia, marzhet, ndërlinjat) vendoset nga redaksia;
2. Redaksia zgjedh një nga sistemet e njohur ndërkombëtarisht të citimeve dhe bibliografisë dhe e shpall publikisht në faqen zyrtare të institucionit, së paku gjashtë muaj para miratimit të lëndës së numrit në vijim.

Neni 21

Indeksi

Revista botohet me ISSN dhe është e indeksuar sipas standardit ndërkombëtar që konfirmohet nga *International Center of ISSN*.

Redaksia merr në konsideratë kërkesat formale të *International Center of ISSN* edhe për paraqitjen teknike të revistës.

Neni 22

Konflikti i interesit

Çështjet e konfliktit të interesit do të adresohen dhe zgjidhen në përputhje me Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike", i ndryshuar.

Neni 23

Ankimi

Autorët mund të paraqesin ankesë me shkrim pranë drejtorit të Revistës për refuzimin e materialit të tyre për botim në Revistë. Ankesa duhet të përmbajë arsyetim të detajuar të pretendimeve, duke iu referuar përgjigjeve të recensuesve ose komenteve të redaktorit shkencor;

Drejtori i revistës, në bashkëpunim me kryeredaktorin, redaktorin shkencor dhe komitetin shkencor marrin vendim për pranimin ose jo të ankimit;

Vendimi për pranimin ose jo të ankimit i njoftohet me shkrim autorit brenda 30 ditëve nga data e regjistrimit të ankimit.

Neni 24

Shpërndarja e revistës

QSPA shpërndan Revistën, brenda dhe jashtë vendit, bibliotekave të sistemit kombëtar, institucioneve bashkëanëtarë në të njëjtat organizata ndërkombëtare, qendrave dhe katedrave të studimeve albanologjike në botë, subjekteve me interes arsimor e shkencor në diasporën shqiptare, si dhe individëve të shquar në studimet shqiptare, sipas kriterëve të përcaktuara në Rregulloren e QSPA-së.

Neni 25

Marrëdhëniet financiare

1. Marrëdhëniet midis Revistës dhe bashkëpunëtorëve të saj rregullohen përmes një kontrate tip, e cila mban në konsideratë misionin dhe qëllimin e botimit të Revistës;
2. Masa dhe format e shpërblimit të autorëve apo bashkëpunëtorëve përcaktohen në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 26

Copyright-i i botuesit dhe i autorit

Pas nënshkrimit të kontratës së botimit të punimit/artikullit shkencor dhe shpërblimit të autorëve, QSPA zotëron të drejtën ekskluzive sipas Ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to”.

Neni 27

Shtypja e Revistës

QSPA është organi përgjegjës për organizimin e procedurave përkatëse për të realizuar botimin e Revistës, sipas përcaktimeve në këtë rregullore.

Neni 28
Ndryshimi apo shfuqizimi

Ndryshimet dhe shtesat e nevojshme në këtë rregullore bëhen me propozim të drejtorit të revistës dhe miratohen nga Këshilli Shkencor i QSPA-së.

Neni 29
Hyrja në fuqi

Rregullorja e veprimtarisë botuese të Revistës hyn në fuqi menjëherë.



Stadardi teknik

Shtojca 1: Standardi teknik në lidhje me formatimin në shtyp

Shtojca 2: Standardi i referencave dhe bibliografisë

